



Republika e Kosovës -- Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.213/2019

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada-Glllogjjani dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate (AAK&PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve të tyre në shtylla elektrike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.213/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, kundër koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Partia Socialdemokrate (AAK&PSD), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Më datë 03.09.2019, subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, ka paraqitur ankesë në PZAP, në të cilën pretendon se më datë 02 Tetor 2019 në orën 22:00, zyrtaret e LDK-se kane vërejtur dhe kane fotografuar afër fakultetit Juridik vendosjen e një foto-posteri te kandidatit për deputet nga koalicioni AAK-PSD dhe kryetarit te Komunës se Prishtinës. Me këtë paraqitësi i ankesës ka pretenduar se ky veprim i koalicionit AAK&PSD është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, respektivisht nenin 33 paragrafi 2 të këtij ligji, poashtu ka shtuar se ky veprim paraqet shkelje të Rregullave Zgjedhore Nr.11/2013 dhe Nr.13/2013.

Paraqitësi i ankesës në mbështetje të pretendimeve në ankesë, si dëshmi ka bashkangjitur fotografi të posterëve të kandidatit për deputetë të koalicionit AAK&PSD.

Në përgjigjen në ankesë të datës 04.10.2019, koalicioni AAK&PSD, thekson se vendosja e këtij posterit nuk përbën shkelje sepse hapësirat ne fjale janë te projektuara për reklama.

Paraqitësi i përgjigjes në ankesë në mbështetje të pretendimeve të tij, si dëshmi ka bashkangjitur disa njoftime që koalicioni AAK&PSD, ka bërë në rrjete sociale për anëtarët

dhe simpatizantët e tij, lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore për fushatën elektorale për zgjedhjet e 6 tetorit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e pabazuar,

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstatoi se nga ana e koalicionit AAK&PSD, nuk është bërë shkelje e nenit 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posterët e kandidatit për deputet nga koalicioni AAK&PSD, janë vendosur në vendin e dedikuar për reklamim - vendosje të posterëve.

Paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet e paraqitësit të ankesës se këto veprime përbëjnë shkelje të Rregullave Zgjedhore Nr.11/2013 dhe Nr.13/2013, nga koalicioni AAK&PSD, pasi që posterët në fjalë janë të vendosur në vendin e dedikuar për vendosjen e tyre, ashtu siç vërtetohet edhe nga fotografitë e bashkangjitura ankesës nga pala ankuese që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga arsyet e theksuar më lartë, e duke u bazuar në nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.213/2019 më datë 05.10.2019

**Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.